



10 MARS 2015

## Komunitetet pakicë jo-serbe të neglizhuar në marrëveshjet teknike në mes të Kosovës dhe Serbisë

Më 9 mars 2015, përfaqësues politikë të komuniteteve pakicë jo-serbe në Kosovë kanë vlerësuar marrëveshjen e drejtësisë të arritur në mes të Kosovës dhe Serbisë muajin e kaluar në Bruksel si skandaloze dhe në kundërshtim me ligjet e Kosovës. Marrëveshja i është dërguar deputetëve të Kuvendit të Kosovës të premten më 6 mars 2015, pothuaj një muaj pas arritjes së marrëveshjes në Bruksel në natën në mes 9-10 shkurtit. Përfaqësues të komuniteteve pakicë jo-serbe në Kosovë, që përfshijnë ashkalinjtë, boshnjakët, egjiptianët, goranët, romët dhe turqit, kanë kritikuar faktin se marrëveshja për drejtësinë përmend vetëm serbët dhe shqiptarët dhe përjashton plotësisht komunitetet e tjera. Ata kanë kërcënuar të dërgojnë rastin për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe në gjykatat përkatëse ndërkombëtare.<sup>1</sup>

Deri më sot nuk janë bërë publike detajet mbi marrëveshjen për drejtësinë, por sipas informatave që kanë rrjedhur dhe janë publikuar në media në Kosovë dhe Serbi,<sup>2</sup> marrëveshja parasheh se do të ketë një Gjykatë themelore dhe një Zyrë e prokurorisë themelore për rajonin e Mitrovicës, me degë në Leposaviq, Zubin Potok, Vushtrri dhe Skenderaj. Marrëveshja i ndan gjykatësit, prokurorët dhe personelin tjetër e Gjykatës themelore dhe Zyrës së prokurorisë themelore në Mitrovicë në mes të një numri të rezervuar të serbëve dhe shqiptarëve dhe përcakton që kryetar i Gjykatës themelore në Mitrovicë do të jetë një serb nga veriu i Kosovës, ndërsa Kryeprokuror i Prokurorisë themelore do të jetë një shqiptar.<sup>3</sup>

Nëntë deputetë të Kuvendit të Kosovës që përfaqësojnë komunitetet pakicë jo-serbe në Kosovë – Duda Balje, Ćerim Bajrami dhe Emilija Redžepi të komunitetit boshnjak, Danush Ademi dhe Etem Arifi të komunitetit ashkali, Kujtim Paçaku i komunitetit rom, Müfera Şinik dhe Fikrim Damka të komunitetit turk, Veton Berisha i komunitetit egjiptian – kanë kritikuar marrëveshjen për drejtësinë, pasi që më në fund kishin marrë atë për vlerësim. Deputetët e lartpërmendur konsiderojnë se rezervimi i një numri të caktuar të vendeve për gjykatës, prokurorë dhe personel mbështetës për Gjykatën themelore dhe Zyrën e prokurorisë themelore në Mitrovicë vetëm për përfaqësues serbë dhe shqiptarë është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, përfshirë parimin e mos-diskriminimit, dhe Ligjin për gjykatat sepse përjashton pjesëtarët e komuniteteve jo-serbe dhe joshqiptare në Kosovë dhe në këtë mënyrë

<sup>1</sup> <http://koha.net/?id=27&l=47778>

<sup>2</sup> <http://koha.net/?id=27&l=47778> dhe

[http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2015&mm=02&dd=10&nav\\_category=640&nav\\_id=956521](http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2015&mm=02&dd=10&nav_category=640&nav_id=956521)

<sup>3</sup> ECMI Kosova. 'Një sistem i unifikuar juridik dhe i gjyqësor në Kosovë?' (15 shkurt 2015).

shkel të drejtën e tyre për punësim dhe përfaqësim të barabartë në institucionet publike në përgjithësi dhe në gjyqësor në veçanti.<sup>4</sup>

Kushtetuta e Republikës së Kosovës thekson se "askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, opinionit politik ose një opinion tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike dhe sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal".<sup>5</sup> Ligji kundër diskriminimit ligjërisht vendos bazat e parimeve të trajtimit të barabartë dhe të përfaqësimit të drejtë të të gjithë personave dhe të të gjithë pjesëtarëve të komuniteteve, përfshirë në fushat e punësimit dhe qasjes në sferën publike.<sup>6</sup>

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton se komunitetet dhe pjesëtarët e tyre do të kenë të drejtë për përfaqësim të barabartë në punësim në institucionet publike.<sup>7</sup> Në lidhje me gjyqësorin në veçanti, Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton se "të paktën pesëmbëdhjetë përqind (15%) e gjyqtarëve nga cilado gjykatë tjetër, e themeluar me juridiksionin e apelit, por jo më pak se dy (2) gjyqtarë, do të jenë të nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë". Neni 104 (2, 3) i Kushtetutës së Kosovës dhe neni 5 i Ligjit për gjykatat specifikojnë më tej se "Përbërja e gjyqësorit pasqyron shumëllojshmërinë etnike të Republikës së Kosovës në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe parimet e njohura ndërkombëtarisht të barazisë gjinore" dhe "përbërjen etnike të juridiksionit territorial të secilit gjykatës përkatëse".<sup>8</sup> Duke pasur parasysh se komunat që bien nën jurisprndencën e Gjykatës themelore në Mitrovicë – Mitrovica e Jugut, Mitrovica e Veriut, Skenderaj, Vushtrria, Zubin Potok, Zveçani, dhe Leposaviqi – janë gjithashtu të banuara me pjesëtarë të komuniteteve pakicë jo-serbe, këto komunitete duhet të jenë të përfaqësuara ose të paktën të jenë në gjendje për të qenë të përfaqësuara në gjyqësor, ndërsa marrëveshja e tanishme duket të ndajë të gjitha pozitat në Gjykatën themelore dhe Zyrën e prokurorisë themelore në Mitrovicë në mënyrë ekskluzive për pjesëtarët e komuniteteve serb dhe shqiptar.

Brenda jurisprndencës evropiane, rasti i Sejdić dhe Finci kundër Bosnjë e Hercegovinës në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut tregon se kuotat etnike për përfaqësim në institucionet publike janë në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut. Rasti i lartpërmendur ka gjetur se dispozitat e Kushtetutës së Bosnjës dhe Hercegovinës që rezervojnë poste në Presidencë dhe në Dhomën e përfaqësuesve të Popullit të Bosnjë-Hercegovinës për serbë, boshnjakë dhe kroatë etnikë janë në kundërshti vetëm me nenin 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cili ndalon diskriminimin në bazë të "seksit, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, opinionit politik ose ndonjë opinion tjetër, origjinës kombëtare ose shoqërore, lidhjes me një minoritet kombëtar, pasurisë, lindjes ose çdo statusi tjetër" në lidhje me të drejtat sipas Konventës,<sup>9</sup> dhe Protokollit të dymbëdhjetë të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, e cili thotë se "gëzimi i çdo të drejtë të përcaktuar me ligj, do të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, opinionit politik ose ndonjë opinion tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, lidhjes me një minoritet kombëtar, pasurisë, lindja ose çdo statusi tjetër".<sup>10</sup> Edhe pse Kosova nuk është anëtare e Këshillit të Europës dhe qytetarët e saj për rrjedhojë nuk kanë qasje në Gjykatën Evropiane

<sup>4</sup> <http://koha.net/?id=27&l=47778>; [http://www.gazetaexpress.com/lajme/marrevshja-per-drejtine-po-vleresohet-diskriminuese-nga-komunitetet-jo-serbe-pritet-ta-dergojne-ne-kushtetuese-video-85791/?utm\\_source=referral&utm\\_medium=web&utm\\_campaign=c](http://www.gazetaexpress.com/lajme/marrevshja-per-drejtine-po-vleresohet-diskriminuese-nga-komunitetet-jo-serbe-pritet-ta-dergojne-ne-kushtetuese-video-85791/?utm_source=referral&utm_medium=web&utm_campaign=c).

<sup>5</sup> *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 24.

<sup>6</sup> *Ligji kundër diskriminimit*, nenet 2 dhe 4.

<sup>7</sup> *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 61.

<sup>8</sup> *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, nenet 103(6), 104(2, 3); *Ligji për gjykatat*, neni 5.

<sup>9</sup> Këshilli i Evropës, *Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut*, neni 14.

<sup>10</sup> Këshilli i Evropës, *Protokoll Nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut*.

për të Drejtat e Njeriut dhe nuk mund të paraqesin ankesa në gjykatën në fjalë, si Konventa ashtu dhe Protokollet e saj janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë.<sup>11</sup>

Kritikat kundër marrëveshjes për drejtësinë në fakt vlejnë për të gjithë procesit e negociatave Kosovë-Serb dhe për marrëveshjet teknike që janë arritur brenda kësaj kornize mes palëve. Këto marrëveshje kanë tendencë që në mënyrë ekskluzive të përqendrohen vetëm në pozitën e komunitetit serb të Kosovës dhe të mos përmendin fare komunitetet e tjera të pakicave që jetojnë në Kosovë. Duke vepruar kështu, këto marrëveshje shkelin parimet e mos-diskriminimit dhe barazisë të të gjitha komuniteteve në Kosovë, të cilat janë baza të vendosura në Kushtetutë dhe në kornizën ligjore të Republikës së Kosovës. Është e domosdoshme që marrëveshjet e ardhshme të marrin në konsideratë përfshirjen dhe madje edhe pjesëmarrjen e komuniteteve tjera në Kosovë dhe të pajtohen me kornizën e përgjithshme shumetnike të Kosovës.

Për më tepër, Dialogu i Brukselit dhe marrëveshjet e arritura kërkojnë më shumë transparencë dhe gjithëpërfshirje. Marrëveshjet e Brukselit shkojnë përtej të ashtuquajturave "marrëveshje teknike", duke pasur parasysh se ato ndikojnë në të gjithë kuadrin kushtetues dhe ligjor.<sup>12</sup> Bashkimi European është vetëm në rolin e lehtësuesit të dialogut në mes të Prishtinës dhe Beogradit, prandaj i është lënë vetë palëve në dialog të informojnë aktorët e tyre përkatës. Megjithatë, deri tani, i gjithë procesi ka qenë plotësisht i mbyllur dhe kuvendi i Kosovës është informuar vetëm pasi që është arritur ndonjë marrëveshje. Me qëllim që marrëveshjet të jenë gjithëpërfshirës dhe politikisht të qëndrueshme, përfshirja e kuvendeve të Kosovës dhe Serbisë është e domosdoshme.

Për më shumë informata ju lutem na kontaktoni në + 381 (0) 38 224 473 ose përmes postës elektronike në [info@ecmikosovo.org](mailto:info@ecmikosovo.org)

---

<sup>11</sup> [Kushtetuta e Republikës së Kosovës](#), neni 22.

<sup>12</sup> ECMI Kosova. [‘Asociacioni/Komuniteti i komunave me shumicë serbe: Shumë spekulime, fare pak marrëveshje faktike dhe moszbatim’](#) (22 shkurt 2015).

## Raporte dhe analiza të tjera politike:

[Deklarata e diskutueshme e ministrit Murati dhe reagimet që pasuan](#)

5 mars, 2015

[Asociacioni/Komuniteti i komunave me shumicë serbe: Shumë spekulime, pak marrëveshje faktike dhe mos-zbatim](#)

22 shkurt, 2015

[Një sistem i unifikuar juridik dhe gjyqësor në Kosovë?](#)

15 shkurt, 2015

[Cfarë duhet të mbahet mend nga rasti Jablanović?](#)

8 shkurt, 2015

[Thirrje për Arsye dhe Veprim pas protestave në Prishtinë](#)

25 janar, 2015

[Farkimi i një ambienti të punës në kuadër të Qeverisë së Kosovës](#)

19 janar, 2015

[ECMI Kosova dënon bllokadën e dhunshme të hyrjes në Kishën Ortodokse Serbe në Gjakovë](#)

7 janar, 2015

[Formimi i Qeverisë së re të Kosovës, Përfaqësimi i komuniteteve pakicë dhe Sfidat që dalin përpara](#)

10 dhjetor, 2014

[Një vështrim mbi situatën e fundit të sigurisë në Kosovë](#)

4 nëntor, 2014

[Komunitetet pakicë dëshirojnë të shohin fundin e ngërçit politik](#)

23 tetor, 2014

[Partitë politike të minoriteteve në mjedisin politik në ndryshim e sipër në Kosovë](#)

31 korrik, 2014

[ECMI Kosova bën thirrje për qetësi pas përshkallëzimit të tensioneve etnike pas ndeshjes kualifikuese në futboll midis kombëtareve të Serbisë dhe Shqipërisë](#)

15 tetor, 2014

[Ndërlidhja e ndarjes: Krijimi i një Bordi të Përbashkët për qytetin e Mitrovicë](#)

27 qershor, 2014

[Zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë: Një Shikim i Çështjeve, sfidave dhe skenës politike në prag të zgjedhjeve të 8 qershorit](#)

2 qershor, 2014

## Rreth ECMI Kosovës

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare e angazhuar me çështje të komuniteteve minoritare në Kosovë, me qëllim të zhvillimit të institucioneve përfshirëse, përfaqësuese dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, institucione këto që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumetnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, dhe përkrah institucionalizimin e mekanizmave qeveritarë të ndërlidhur me çështje të komuniteteve, dhe ngrit kapacitetet e akterëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për t'u angazhuar me njëri-tjetrin dhe bashkëpunuar në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.